

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6294
E hënë, 19 prill 2021
çmimi 0.40 €

Slovenia ngre pyetje të pakëndshme me bisedat për "shpërbërjen" e Bosnjës FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SAFET GËRHXHALIU FAQE 4-5

QEVERIA TA HARTOJË NJË PAKO TË RE PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE

Eksperti i ekonomisë, Safet Gërxhaliu, ka kërkuar nga qeveria që ta hartojë një pako të re për rimëkëmbjen ekonomike. Sipas tij, Kosova ngelet larg vendeve të rajonit sa i përket ndihmës për sektorin privat. "Tani për Kosovën është urgjente një pako e re e rimëkëmbjes e cila do të ketë rëndësi të pakontestuar në aspektin ekonomik, social dhe zhvillimor. Mbi të gjitha, edhe në aspektin psikologjik dhe emocional, në mënyrë që qytetarët ta ndiejnë dorën e shtetit", ka thënë Gërxhaliu për gazetën "Epoka e re". Ai e ka hedhur poshtë mundësinë që vendi të mbyllet për shkak të pandemisë. "Duhet të analizohet çfarë është e kundërta e mbylljes", është shprehur Gërxhaliu



OPINION

A KA KOSOVA NJË STRATEGJI EFIKASE SHTETËRORE? F. 8

Nga Mehmet PRISHTINA



AKTUALE



OSMANI, KONJUFCA DHE KURTI NDEROJNË DËSHMORËT E PRISHTINËS F. 7

KRYETARI I PRISHTINËS GJOBITET PËR DITËLINDJE PASI NUK RESPEKTOI MASAT KUNDËR COVIDIT F. 6

REPUBLIKA ÇEKE DËBON 18 DIPLOMATË RUSË F. 2




EKONOMI



DREJT NJË LIGJI QË MBAN NËN LLUPË PASURINË E PAJUSTIFIKUESHME F. 9

762 PACIENTË, TË INFEKTUAR ME COVID, PO TRAJTOHEN NË SPITALET E KOSOVËS

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar të dielën se në Kosovë kanë vdekur edhe njëmbëdhjetë pacientë të infektuar me Covid-19. Sipas këtij institucioni, në 24 orët e fundit janë regjistruar edhe 364 raste të të infektuarve me këtë virus, pas testimit të 3 501 mostrave të marra prej personave të dyshuar. Në klinikat Covid të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet e përgjithshme aktualisht janë duke u trajtuar 762 pacientë nga Covid-19, prej tyre 43 janë në gjendje të rëndë FAQE 5



VAZHDON ORA POLICORE, HAPET GASTRONOMIA FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçishtë-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Republika Çeke dëbon 18 diplomatë rusë

Republika Çeke ka urdhëruar dëbimin e 18 diplomatëve rusë, duke i akuzuar ata se janë spiunë, pasi intelijenca çeke ka lidhur agjentët ushtarakë rusë me një shpërthim në një depo municioni më 2014. Si pasojë e këtij shpërthimi kanë vdekur dy persona. Një zyrtar i lartë i parlamentit rus

e ka quajtur këtë pretendim absurd. Kryeministri çek Andrej Babish ka thënë se shteti është dashur të veprojë ndaj publikimeve që lidhin shpërthimin, me shërbimin ushtarak të inteligjencës së Rusisë, GRU. Në një konferencë televizive të shtunën, Babish ka thënë se 18

diplomatët, të cilët janë identifikuar se kanë punuar për shërbimet ruse të inteligjencës, kanë 48 orë për t'u larguar nga shteti. "Ka dyshime të arsyeshme se agjentët sekretë rusë të shërbimit GRU kanë qenë të përfshirë në shpërthimin e vitit 2014 në depon e armëve në fshatin çek Vrbitce", ka thënë ai.



Izraeli shfuqizon masën për vendosje të maskës në ambiente të jashtme

JERUSALEM, 18 PRILL - Autoritetet izraelite kanë njoftuar se vendosja e maskës nuk do të jetë më e detyrueshme në ambiente të jashtme. Të gjitha shkollat janë hapur në këtë vend, në kuadër të masave për t'iu kthyer normalitetit, pas fushatës së gjerë të vaksinimit kundër koronavirusit. Me një popullsi prej 9.3 milionë banorësh, Izraeli ka vaksinuar



54 për qind të qytetarëve të vet me dy doza të vaksinës Pfizer/BioNTech.

Ministria e Shëndetësisë në këtë vend ka thënë se ndonëse vendosja e maskës nuk do të jetë më e detyrueshme jashtë, masa për vendosjen e saj do të vlejë ende për hapësirat e brendshme publike. Ministria e Edukimit ka thënë se tani, pas kthimit të të gjithë fëmijëve nëpër shkolla, këto institucione duhet ta inkurajojnë mbajtjen e

higjienës personale, ventilimin e klasave dhe mbajtjen e distancës fizike sa më shumë që është e mundur gjatë pushimeve mes orëve të mësimt. Izraeli i konsideron palestinezët në Jerusalemin Lindor si pjesëtarë të popullsisë së vet, andaj ka vaksinuar njerëzit edhe atje. Ndërkohë 5.2 milionë

palestinezët në Bregun Perëndimor dhe në Rripin e Gazës, të kontrolluar nga Hamasi, kanë pranuar një sasi të kufizuar të vaksinave nga Izraeli, Rusia, Emiratet e Bashkuara Arabe, Kina dhe skema COVAX e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, e cila synon të shpërndajë vakcina kundër koronavirusit për vendet e varfra.

Siria do t'i mbajë zgjedhjet presidenciale në maj

DAMASK, 18 PRILL - Siria do t'i mbajë zgjedhjet presidenciale muajin e ardhshëm, ka njoftuar parlamenti i këtij shteti. Presidenti sirian Bashar al-Assad nuk pritet të përballë me opozitë serioze pavarësisht prej konfliktit dhe krizës ekonomike në rritje. Pas dhjetë vjetësh të luftës, Qeveria siriane kontrollon pjesën më të madhe të shtetit. Si pasojë e luftës kanë vdekur rreth 400 000 persona dhe gjysma e sirianëve janë shpërngulur.

Zgjedhjet për pozitën e presidentit, me mandat shtatëvjeçar, do të mbahen më 26 maj, ka thënë kryeparlamentari Hamouda Sabbagh. Kandidatët duhet të regjistrohen nga dita e hënë, derisa sirianët jashtë shtetit do të mund të votojnë nëpër ambasada deri më 20 maj. Këto janë zgjedhjet e dyta që mbahen në këtë shtet gjatë luftës civile. Në zgjedhjet e fundit, të



mbajtura më 2014, të konsideruara nga opozita, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, si jodemokratike dhe joligjore, Assad ka fituar 92 për qind të votave. Për herë të parë në zgjedhjet e vitit 2014, pas disa dekadash, dikush tjetër, përveç familjes Assad, është lejuar të garojë për president të Sirisë. Megjithatë, të dy kandidatët nuk kanë qenë të njohur dhe kanë fituar pak vëmendje.

ShBA-ja dhe Kina zotohen për bashkëpunim në fushën e ndryshimeve klimatike

WASHINGTON, 18 PRILL - Shtetet e Bashkuara dhe Kina janë pajtuar se rritja e zotimeve për t'iu luftuar ndryshimet klimatike duhet të jetë në linjë me Marrëveshjen e Parisit për Klimën, është thënë në një deklaratë të përbashkët, pasi i dërguari amerikan për klimën, John Kerry, ka vizituar Shangain. "Shtetet e Bashkuara dhe Kina janë të përkushtuara që të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me shtetet e tjera për ta luftuar krizën klimatike e cila duhet të trajtohet me seriozitetin dhe urgjencën që kërkon", është



thënë në deklaratën e përbashkët. Në deklaratë janë renditur disa fusha në të cilat ShBA-ja

dhe Kina mund të bashkëpunojnë, përfshirë Marrëveshjen e Parisit për Klimën, të arritur më 2015.

Kerry ka ndihmuar në negociim të Marrëveshjes në Paris kur ka qenë në pozitën e sekretarit amerikan të Shtetit. ShBA-ja është tërhequr nga marrëveshja gjatë administratës së ish-presidentit Donald Trump, mirëpo presidenti amerikan Joe Biden e ka kthyer mbrapsht atë vendim, pak pasi ka marrë pozitën në muajin janar. Shtetet e Bashkuara dhe Kina do të punojnë për strategji afatgjatë të zhvillimit, që synojnë neutralitetin e karbonit dhe maksimizimin e investimeve ndërkombëtare

në mbështetje të kalimit në energji të ripërtërishme në vendet në zhvillim", është thënë në deklaratë. Këto dy vende janë përgjegjëse për gati gjysmën e emetimeve të gazrave serrë në botë. Të dyja shtetet, dhe emetuesit tjerë të mëdhenj, janë duke u përgatitur për një Samit të Kombeve të Bashkuara për Klimën, që do të mbahen në Skoci në muajin nëntor. Samiti synon t'i rikthejë përpjekjet globale për ta mbajtur temperaturën mesatare globale nën 2 gradë celsius, siç parashihet në Marrëveshjen e Parisit.

Sllovenia ngre pyetje të pakëndshme me bisedat për “shpërbërjen” e Bosnjës

PRISHTINE, 18 PRILL - Një debat publik, që lindi në Slloveni, u përhap javën që lamë pas në Bosnje e Hercegovinë dhe në BE dhe nxitu pyetje të pakëndshme për qëndrueshmërinë e kufijve dhe të institucioneve në Ballkan, e sidomos në Bosnje.

Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, raportohet se ka folur për “shpërbërjen” e mundshme të Bosnje e Hercegovinës gjatë një bisede me presidenten trepalëshe të Bosnjës muajin e kaluar.

Raporte të pakonfirmuara këtë javë kanë cituar një “non-paper” të kryeministrit slloven, Janez Jansa, që u bënë jehonë bisedave për ndryshimin e mundshëm të kufijve.

Publikisht, të dy udhëheqësit i kanë mohuar sugjerimet se mbështesin një ide të tillë.

Pahor ka thënë të premtën se i hedh poshtë “lojërat e rrezikshme” për ndryshimin e kufijve, ndërsa Jansa ka mohuar se ekziston një “non-paper” i tillë.

Por, alarmi është ngritur tek ata që mendojnë se reformat janë mënyra më e mirë për ta nxjerrë Bosnjën nga paraliza politike. “Ideja e ndryshimit të kufijve është e rrezikshme”, thotë Florian Bieber, drejtor i Qendrës për Studime të Evropës Juglindore në Universitetin e Gracit në Austri.

Ai përmend rrezikun e veçantë në Ballkan, ku është përfolur se udhëheqësit e Kosovës dhe të Serbisë e kanë konsideruar shkëmbimin e mundshëm të territoreve tre vjet më parë. Ai, po ashtu, paralajmëron për përhapjen e paqëllimit të rrezikut në vende si Ukraina, ku Rusia ka aneksuar Krimenë shtatë vjet më parë dhe vazhdon t’i mbështesë separatistët e armatosur. “Ishte shumë e rrezikshme të flitej për ndryshimin e kufirit midis Kosovës dhe Serbisë, e kjo është edhe më e rrezikshme në Bosnje, sepse do të përfshinte jo vetëm një proces jokonsensual, por do t’i ndikonte edhe njerëzit kundër vullnetit të tyre, si dhe do ta flakte qasjen e komunitetit ndërkombehtar, që ka qenë në fuqi qysh në vitin 1991, e që do të thotë se asnjë ndryshim kufiri përgjatë vijave etnike nuk është i pranueshëm”, thotë Bieber.

Një portal slloven i lajmeve ka njoftuar së pari më 11 prill se Pahor i ka pyetur bashkëpresidentët e Bosnjës, në një takim më 5 mars, nëse “ndarja në mënyrë paqësore” është një mundësi për Bosnjën, e cila ende qeveriset në dy entitete: Federata Boshnjake-Kroate dhe Republika Sërpska. Kjo qeverisje e ndërlukuar është paraparë me Marrëveshjen e Dejtonit, e cila i ka dhënë fund



luftës në Bosnje më 1995.

Kroati Zheko Komshiq ka thënë një ditë më vonë se pyetja i është bërë atij dhe dy anëtarëve të tjerë të Presidencës së Bosnjës në një takim në mars. Zyra e Pahorit më vonë ka konfirmuar se ai i ka pyetur udhëheqësit e Bosnjës për “idenë e shpërbërjes së Bosnje e Hercegovinës dhe ripërcaktimin e kufijve në Ballkanin Perëndimor” gjatë një vizite në Sarajevë në fillim të marsit.

Sipas raporteve, Millorad Dodik, anëtari serb i Presidencës dhe udhëheqësi i Republikës Sërpska, i cili së voni i ka shtuar thirrjet e tij për shkëputje nga pjesa tjetër e Bosnjës, i është përgjigjur më ngrohtë idesë sllovene sesa homologët e tij, ai boshnjak dhe kroat.

Pahor më pas ka theksuar “mbështetjen” e tij për anëtarësimin e Bosnjës në BE dhe respektin e tij për integritetin territorial të vendit.

Pastaj, këtë javë, kanë dalë raporte që sugjerojnë se Jansa personalisht i ka dorëzuar një “non-paper” presidentit të Këshillit Evropian, Charles Michel, ku përmenden ndryshimet e mundshme të kufijve.

Jansa, aleat politik i kryeministrit nationalist hungarez Viktor Orban, ka mohuar se ka shkruar një “non-paper” të tillë.

Një zyrtar i BE-së është përgjigjur në emër të zyrës së Michelit më 12 prill, duke thënë se “ne nuk mund të konfirmojmë se kemi marrë” një dokument të tillë.

Më 15 prill, një medium me qendër në Lubjanë, necenzurirano.si, ka botuar atë që ka thënë se është “non-paper”-i në fjalë.

Në këtë “non-paper” të pretenduar, me titull “Ballkani Perëndimor - rruga përpara”, Jansa propozon “zgjidhje” që përfshijnë “bashkimin e Kosovës dhe Shqipërisë” dhe “bashkimin e një pjese më të

madhe të territorit të Republikës Sërpska me Serbinë”.

Ai propozon status të veçantë duke ndjekur modelin e Tirolit të Jugut, provincës kryesisht gjermanishtfolëse në veri të Italisë - për “pjesën serbe të Kosovës”.

Po ashtu, sugjeron ose “bashkimin e kantoneve kryesisht kroate të Bosnje e Hercegovinës me Kroacinë, ose dhënien e statusit të veçantë për pjesën kroate të Bosnje e Hercegovinës”.

Boshnjakët, “kështu do të fitojnë një shtet që funksionon në mënyrë të pavarur dhe do ta marrin përgjegjësinë për të”.

Bosnje e Hercegovina është përballur me probleme pothuajse konstante të qeverisjes që nga krijimi i saj me dy njësitë etnike.

Brukseli dhe përfaqësuesi i tij i lartë për politikën e jashtme, Josep Borrell, kanë theksuar vazhdimisht dëshirën e bllokut për të parë një angazhim më të madh të zyrtarëve të Bosnjës për reforma, që do t’i mundësonin vendit të përparonte drejt BE-së. Por, çështjet e pazgjidhura,

përfshirë paqëndrueshmërinë e vazhdueshme politike të Bosnjës, vazhdojnë.

Muajin e kaluar Ministria e Jashtme e Kroacisë është cituar të ketë thënë se Zagrebi ka qenë “nxitësi” i një nisme këtë vit për të hartuar një “non-paper”, ku Bosnja do të nxirrej si “një çështje e rëndësishme për Bashkimin Evropian, e cila duhet të jetë më e dukshme në hapësirën gjeopolitike në Evropën Juglindore”.

Institucionet e BE-së dhe vendet anëtare, herë pas here, ndajnë dokumente të tilla konfidenciale, por jozyrtare, që sugjerojnë korniza të mundshme për diskutimin e temave veçanërisht të mbingarkuara.

Në “non-paper”-in kroat, ministri i Jashtëm, Gordan Gërlli Radman, ka mbështetur statusin e kandidatit të Bosnjës për anëtarësim në BE.

Sllovenia ishte midis nënshkruesve të tjerë, ashtu si edhe Bullgaria, Qiproja, Greqia dhe Hungaria.

Gërlli Radman ka thënë, pas një takimi të ministrave të

jashtëm të BE-së, më 22 mars, se homologët e tjerë evropianë - përfshirë ata nga Franca dhe Gjermania - kanë shprehur mbështetje për dokumentin.

Në “non-paper” është thënë se Bosnja duhet ta reformojë legjislacionin e saj zgjedhor përpara zgjedhjeve të përgjithshme të vitit të ardhshëm.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, i ka bërë thirrje presidencës trepalëshe të Bosnjës këtë muaj, që të punojë drejt reformave të paktën modeste, përfshirë “ndryshime të limituara kushtetuese... për ta reformuar sistemin zgjedhor”.

Sllovenia do ta marrë presidencën e radhës të BE-së në gjysmën e dytë të vitit 2021.

Ndoshta Pahor dhe Jansa thjesht kërkojnë të mbledhin pikë politike, duke ofruar zgjidhje për

paqëndrueshmërinë e vazhdueshme midis ish-republikave jugosllave në juglindje.

Disa analistë spekulojnë se udhëheqësit sllovenë mund ta kanalizojnë pakënaqësinë me Bosnjën edhe midis “aktorëve më të mëdhenj” brenda Bashkimit Evropian.

Mateusz Seroka, një studiues në Qendrën për Studime Lindore në Varshavë, thotë për Radion Evropë e Lirë se ripërcaktimi i kufijve është një gjë e dështuar - “një mundësi e tillë do të shkaktonte më shumë probleme sesa do të mund të zgjidhte teorikisht”. Por, duke folur përpara rrjedhjes së “non-paper”-it, ai ka thënë se “ka ende grupe që mendojnë për ndarjen e rajonit të Ballkanit Perëndimor përgjatë vijave etnike” dhe nuk ka fajësuar domosdoshmërisht Lubjanën për ngritjen e kësaj teme. (REL)





FLET PËR "EPOKËN E RE", SAFET GËRXHALIU

Qeveria ta hartojë një pako të re për rimëkëmbjen ekonomike

Eksperti i ekonomisë, Safet Gërxhaliu, ka kërkuar nga qeveria që ta hartojë një pako të re për rimëkëmbjen ekonomike. Sipas tij, Kosova ngelet larg vendeve të rajonit sa i përket ndihmës për sektorin privat. "Tani për Kosovën është urgjente një pako e re e rimëkëmbjes e cila do të ketë rëndësi të pakontestuar në aspektin ekonomik, social dhe zhvillimor. Mbi të gjitha, edhe në aspektin psikologjik dhe emocional, në mënyrë që qytetarët ta ndiejnë dorën e shtetit", ka thënë Gërxhaliu për gazetën "Epoka e re". Ai e ka hedhur poshtë mundësinë që vendi të mbyllet për shkak të pandemisë. "Duhet të analizohet çfarë është e kundërta e mbylljes", është shprehur Gërxhaliu

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 18 PRILL - Njohësi i çështjeve ekonomike, Safet Gërxhaliu, ka thënë se qeveria Kurti me urgjencë duhet ta hartojë një pako të re të rimëkëmbjes ekonomike. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosovës do t'i duhet dyfishi i kohës së vendeve të rajonit sa i përket rimëkëmbjes ekonomike pas Covid-19. "Nëse vendeve të rajonit i nevojiten dy ose tri vjet për t'u rimëkëmbur nga pandemia, atëherë Kosovës i duhet dyfishi i kësaj periudhe. Në këtë drejtim nuk duhet që Kosova të shndërrohet në hapësirë eksperimentale", ka deklaruar Gërxhaliu, cili ka bërë

thirrje për hartimin e një pakoje të re të rimëkëmbjes ekonomike. "Apeli im do të ishte për qeverinë Kurti që, në rend të parë, ta hartojë një strategji apo një pako të re të rimëkëmbjes dhe tek atëherë të mendohet për masat. Besoj që në këtë drejtim janë duke punuar ekspertë të fushave ekonomike. Tani është koha për një pako gjithëpërfshirëse ku askush s'ka mundësi të përfitojë në baza selektive. Në këtë drejtim sa më tepër të investohet sot do të jetë më lehtë procedura për sanim", është shprehur ai.

Sa i përket raportit të Bankës Botërore, se rritja ekonomike në vitin 2021 do të jetë prej 4-përqindësh, Gërxhaliu ka shprehur skepticizëm rreth

kësaj shifre. "Nuk pajtohem me raportin e Bankës Botërore që Kosova në vitin 2021 do të ketë rritje 4 për qind. Kosovës do t'i duhen dy vjet për sanim si pasojë e kësaj pandemie. Realiteti në Kosovë është më ndryshe dhe nevojitet një analizë më ndryshe. Tani për Kosovën është urgjente një pako e re e rimëkëmbjes e cila do të ketë rëndësi të pakontestuar në aspektin ekonomik, social dhe zhvillimor. Mbi të gjitha, edhe në aspektin psikologjik dhe emocional, në mënyrë që qytetarët ta ndiejnë dorën e zgjatur të shtetit", ka thënë Gërxhaliu. Sipas tij, çështja e pandemisë në Kosovë duhet të menaxhohet në katër etapa. "Bota nuk do të jetë siç ka qenë

para pandemisë. Duhet të bëhet një riorganizim. Problemi më i madh është se pandemia është politizuar. Më gëzon fakti se, më në fund, Kosova ka institucione stabile dhe se në kabinetin qeveritar ka ekspertë të fushave. Menaxhimi i pandemisë duhet të ndahet në katër etapa. E para skenimi, pastaj planifikimi, vendimi dhe mbështetja", ka thënë ai.

Gërxhaliu ka folur edhe për përparimin ekonomik të vendeve të rajonit në kohën e pandemisë. "Vendet e rajonit kanë bërë shumë më tepër për mbështetje të bizneseve dhe qytetarëve në kohën pandemisë, e te ne duhet analizë e thuktë para çdo vendimi", ka deklaruar ai.

Gërxhaliu ka theksuar se duhet të bëhet një inspektim i mirëfilltë për personat e infektuar me Covid-19 të cilët po enden lirshëm rrugëve, derisa e ka hedhur poshtë mundësinë e një mbyllje totale të vendit. "Mbetet brengosëse se kush kujdeset për të infektuarit të cilët edhe pse kanë rezultuar pozitiv me Covid-19, breshin rrugëve të Kosovës. E rrugës do të ishte që të kemi mekanizëm verifikues sesa të

mbyllet ekonomia. Prandaj, distanca, disiplina, maskat duhet të shfrytëzohen dhe monitorohen. Besoj se monitorimi i pandemisë është shumë më i rëndësishëm sesa i masave mbyllëse. Duhet të ketë shumë më shumë inspektorë dhe disiplinë për respektimin e masave kundër Covidit", ka thënë ai.

Njohësi i çështjeve ekonomike, Safet Gërxhaliu, ka theksuar se Kosova duhet ta digjitalizojë sistemin e shëndetësisë në rastin e Covid-19 që vendi të mos hyjë në katrahurë menaxhuese shëndetësore. "Në këtë drejtim Kosova vuan nga mungesa e databazave për pacientët e infektuar. Ky është problem edhe për vaksinimin, sepse mungon historiografia e pacientëve, qoftë atyre të infektuar apo atyre me sëmundje të tjera. Prandaj është koha kur duhet të kemi një qasje më ndryshe përballë sfidave të pandemisë dhe në këtë drejtim duhet të analizohet çfarë është e kundërta e mbylljes. Por, mbi të gjitha, duhet të analizohet shumë më shumë aksi i monitorimit të këtyre rasteve", ka thënë Gërxhaliu.

762 pacientë, të infektuar me Covid, po trajtohen në spitalet e Kosovës

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar të dielën se në Kosovë kanë vdekur edhe njëmbëdhjetë pacientë të infektuar me Covid-19. Sipas këtij institucioni, në 24 orët e fundit janë regjistruar edhe 364 raste të të infektuarve me këtë virus, pas testimi të 3 501 mostrave të marra prej personave të dyshuar. Në klinikat Covid të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet e përgjithshme aktualisht janë duke u trajtuar 762 pacientë nga Covid-19, prej tyre 43 janë në gjendje të rëndë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 PRILL- Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 3 501 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 364 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar 11

raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Prishtinë dy raste (80, 68 vjeç), Vushtrri dy raste (78, 65 vjeç), Ferizaj një rast (71 vjeç), Gjakovë një rast (72 vjeç), Klinë një rast (81 vjeç), Lipjan një rast (70 vjeç), Mitrovicë një rast (72 vjeç), Prizren një rast (77 vjeç), Rahovec një rast (67 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 101 517 raste nga 500 112 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 2072 raste të të vdekurve. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 529 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 87 012 raste, kurse numri i

rasteve aktive është 12 433. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 115 raste, Mitrovicë 50 raste, Gjilan 40 raste, Gjakovë 29 raste, Ferizaj 21 raste, Pejë 20 raste, Podujevë 18 raste, Fushë-Kosovë 10 raste, Drenas 9 raste, Prizren 9 raste, Lipjan 7 raste, Rahovec 7 raste, Vushtrri 5 raste, Dragash 4 raste, Shtime 4 raste, Kamenicë 3 raste, Klinë 3 raste, Deçan 2 raste, Istog 2 raste, Viti 2 raste dhe me nga një rast komunat Junik, Kaçanik, Malishevë dhe Obiliq.

Në klinikat Covid të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet e përgjithshme aktualisht janë duke u trajtuar 762 pacientë nga Covid-19, prej tyre 43 janë në gjendje të rëndë.


Për tri ditë në sallën “1 Tetori” janë vaksinuar 827 persona me sëmundje kronike

Në Kosovë është duke vazhduar procesi i vaksinimit kundër Covid-19 në sallën “1 Tetori” në Prishtinë. Edhe të dielën në këtë qendër po vaksinohen personat e grupmoshës 75 deri 79 vjeç të cilët kanë sëmundje kronike. Vetëm gjatë orëve të para të së dielës në sallën “1 Tetori” janë vaksinuar 103 persona. Për tri ditë janë vaksinuar 827 persona me sëmundje kronike, kurse gjithsej janë vaksinuar 1 180 të moshuar ka bërë me dije koordinatori i qendrës së vaksinimit në sallën “1 Tetori”, Niman Bardhi, në konferencë për media. “Nëse i referohemi vetëm pjesës të të sëmurëve

kronikë për tri ditë deri në këto çaste kemi aktualisht 827 persona të vaksinuar, kurse të moshuar deri në këto çaste kemi 1 180”, ka thënë Bardhi. Më 28 mars Kosova i ka pranuar 24 mijë dozat e para të vaksinës kundër Covid-19. Këto doza të vaksinës “AstraZeneca” u dhuruan për qytetarët e Kosovës nga COVAX-i. Ata që kishin prioritet për t’u vaksinuar ishin profesionistët shëndetësorë, më pas qytetarët mbi moshën 80 vjeç dhe ata me sëmundje kronike. I pari që e mori dozën e vaksinës “AstraZeneca” ishte kryeministri i Kosovës, Albin Kurti.



Mbetet ora policore, hapet gastronomia



PRISHTINË, 18 PRILL- Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së dielës ka shqyrtuar masat e reja kundër Covidit. Nga e hëna do të lejohet puna e gastronomisë, e objekteve hoteliere, e restoranteve dhe kafiterive të cilat do të punojnë deri në orën 22:00. Gjithashtu, do të hapen edhe qendrat tregtare. Por, do të vazhdojë kufizimi i lëvizjes, por tani nga ora 22:30 deri në 05:00.

Gastronomia dhe qendrat tregtare do të lejohen ta zhvillojnë aktivitetin e tyre në përputhje me udhëzuesin e përkohshëm për

aplikimin e masave për parandalimin dhe luftimin e Covid-19.

Më 5 prill Qeveria e Kosovës ka miratuar masat e propozuara nga ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, të cilat kanë hyrë në fuqi nga data 7 prill.

Me këto masa të cilat kanë qenë të vlefshme deri më 18 prill, është ndaluar pjesërisht gastronomia, duke u lejuar vetëm shërbimet “merr me vetë” dhe me dërgesë. Po ashtu, qendrat tregtare dhe fitneset kanë qëndruara të mbyllura për 12 ditë.

Totaj: Prokuroria ta hetojë Haskukën pas skandalit me tenderin 1.4 milion euro

PRIZREN, 18 PRILL (ER) - Kryetari i Degës së PDK-së në Prizren, njëherësh nënkryetar i kësaj partie, Shaqir Totaj, ka mbajtur konferencë për media lidhur me skandalet korruptive në Komunën e Prizrenit, për arrestimet e fundit dhe për largimin e të gjitha partive politike opozitare nga selitë e tyre në Prizren.

Totaj ka kërkuar nga prokuroria ta hetojë edhe kryetarin e Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, pas skandalit me tenderin 1.4 milion euro të Komunës së Prizrenit, nën dyshimet e aplikimit me dokumente të rrejshme, ku u arrestuan disa persona pas publikimit të një raporti të organizatës joqeveritare "Avonet".

Sipas Totajt, parulla me "Mytën do ta mbysim korrupsionin" është shndërruar në parullën "Myta është mbytur në korrupsion". "Ky skandal i madh nuk duhet të kalojë pa

përgjegjësi politike. Ne jemi të bindur se në këtë skandal korruptiv është i përfshirë edhe vetë Haskuka dhe personat e afërt me të, prandaj apelojmë tek organet e shtetit që ta zgjerojnë pistën e hetimeve duke përfshirë kryetarin Haskuka, drejtorin Osman Krasniqi, ish-drejtorin Levent Kasemi dhe shefin e prokurimit", ka thënë ai.

Totaj është shprehur se pushteti i korruptuar i udhëhequr nga Mytaher Haskuka dhe motivuar nga Albin Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje po synon ta frikësojë opozitën, ta intimidojë, t'ia mbyllë gojën dhe t'ia pamundësojë veprimtarinë e saj politike në shërbim dhe interes të qytetarëve të Prizrenit, duke i larguar partitë opozitare nga selitë e tyre me qëllim që ata të heshtin karshi abuzimeve dhe aferave korruptive në Komunën e Prizrenit.



Përkujtohet masakra e Poklekut dhe e Çikatovës së Vjetër



DRENAS, 18 PRILL (ER) - Me rastin e shënimit të 22-vjetorit të masakrës së 54 martirëve të familjes Muqolli dhe Elshani në Poklek dhe vrasjes së 24 civilëve në fshatin Çikatovë e Vjetër, kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, së bashku me kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, deputetë të Kuvendit, shoqata të dala nga lufta, familjarë e qytetarë, kanë bërë homazhe në varrezat e

tyre dhe kanë vendosur buqeta me lule të freskëta. Fillimisht homazhet dhe vendosja e buqetave me lule janë bërë te lapidari i varrezave të fshatit Poklek për t'i nderuar 54 martirët e familjes Muqolli dhe Elshani, pastaj homazhe dhe buqeta me lule janë bërë dhe vendosur në varrezat e 24 martirëve të fshatit Çikatovë e Vjetër. Pas homazheve, vizita është bërë te familja Demaku me rastin e lirimit të Fadil dhe Nexhat Demakut.

Kryetari i Prishtinës gjobitet për ditëlindje pasi nuk respektoi masat kundër Covidit

PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, është gjobitur nga policia dhe inspektorët për mosrespektim të masave kundër Covid-19. Ai ka thënë se është çuditur se si "pa nisur ende një mbledhi familjare në hapësirë private, dikush kishte lajmëruar se po ndodh dasmë".

Ahmeti përmes një postimi në rrjetin social "Facebook" ka thënë se ka festuar ditëlindjen me familjen e tij në një

hapësirë private, ndërsa më pas aty kishin shkuar policia dhe inspektorët e AVUK-ut. "Mbrëmë kam festuar ditëlindjen me familje në një hapësirë private, jo biznes. Aty kemi qenë rreth 15 persona prej të cilëve gjysma familjarë (në mes tyre bashkëshortja dhe fëmijët). Ende pa filluar, pra rreth orës 20:00 (dy orë para orës policore), kanë ardhur tri vetura të policisë dhe dy të AVUK-ut të cilët më kanë thënë se dikush ka lajmëruar dasmë.

U çudita se si pa nisur ende një mbledhi familjare në hapësirë private, dikush paska lajmëruar 'dasmë'. Unë kërkoja që të gjobitemi sipas ligjit. Unë dhe mysafirët u dënuam me gjoba për mosmbajtje të distancës dhe maskave nga 35 euro. Në këso rrethanash dhe pa hyrë në konspiracione, me sinqeritetin më të madh e falënderoj Policinë e Kosovës dhe AVUK-un për sjellje profesionale gjatë vizitës", ka bërë me dije Ahmeti.



Nisin punimet në rrugën "Bedri Pejani" në Vushtrri

VUSHTRRI, 18 PRILL (ER) - Kanë filluar punimet në rrugën "Bedri Pejani" te rrethi e deri tek ish-

stacioni i vjetër në Komunën e Vushtrrisë. Kjo komunë ka njoftuar se afati i përfundimit të punimeve

është fundi i muajit maj të këtij viti. Në kuadër të këtyre punimeve do të rregullohet infrastruktura

nëntokësore, vendosja e kanaleve për kabllot elektrike, të internetit si dhe ndriçimi publik.



Osmani, Konjufca dhe Kurti nderojnë dëshmorët e Prishtinës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e shoqëruar nga kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca dhe kryeministri Albin Kurti, kanë bërë homazhe të dielën te varrezat e dëshmorëve të Prishtinës në lagjen "Velania". Presidentja Osmani ka thënë se Dita e Dëshmorëve të Prishtinës është ditë për ta nderuar sakrificën sublime që dhanë të gjithë të rënë të këtij rajoni. "Sot është Dita e Dëshmorëve të Prishtinës, një prej ditëve që të gjithë bëhemi bashkë për ta nderuar sakrificën sublime që të gjithë dëshmorët e këtij rajoni e bënë, në mënyrë që ta gëzojmë lirinë. Është dita kur duhet t'u flasim brezave të ardhshëm për trimërinë e dëshmorëve të Kosovës, dëshmorëve si pjesë e luftës sonë çlirimtare dhe si pjesë e UÇK-së", ka thënë presidentja Osmani. Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se sakrificat e dëshmorëve qëndron e palëkundur në themelet e shtetit tonë. "Pa sakrificën dhe rënien e dëshmorëve nuk do të ishte e mundshme liria e popullit tonë

dhe as shtetësia dhe as pavarësia e vendit tonë. Kështu që, sa të ketë gjallë komb shqiptar ata do të nderohen dhe do të respektohen gjithmonë. Mendoj se pjesë më e lavdishme e historisë sonë të re të Kosovës është lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, martirët dhe dëshmorët e rënë", ka thënë Konjufca. Në shënim të kësaj dite kryeministri Albin Kurti ka thënë se sot bënë nderime te varrezat e dëshmorëve të kryeqytetit të cilët luftuan për liri dhe ranë heroikisht që të ngrehet edhe kauza jonë, e më pas të vijë çlirimi, liria dhe pavarësia. "Andaj në kthehemi e rikthehemi në këto vende në mënyrë që t'i kujtojmë ata, t'ia përkujtojmë vetes çmimin e madh që ka paguar populli ynë me gjakun e vet, për lirinë dhe pavarësinë që e kemi sot, në të njëjtën kohë edhe për t'i përkujtuar amanetet dhe idealat e tyre që të vazhdojmë për përparim, për barazi e mirëqenie që nuk e përjashton asnjërin", ka thënë kryeministri Kurti, duke shtuar se dëshmorët e kombit e bashkojnë popullin. Dëshmorët e Prishtinës i ka përkujtuar edhe kryetari Shpend Ahmeti. "Në pamundësi të tubimit fizik, sot



virtualisht përulemi para dëshmorëve të Prishtinës. U themi familjeve që në vend të pikëllimit të kenë krenari që në

familjet e tyre kishin njerëz që ishin të gatshëm ta sakrifikojnë jetën që ne të jetojmë të lirë. Në Ditën e Dëshmorëve të

Prishtinës edhe ne i përkujtojmë me krenari", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

PRAK-u: U shkelën të drejtat e pacientëve gjatë pandemisë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 PRILL - Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë (PRAK), në Ditën Evropiane për të Drejtat e Pacientëve, ka thënë se kjo ditë e gjen pacientin e Kosovës më shumë se asnjëherë tjetër të ekspozuar ndaj një rreziku të madh shëndetësor siç është pandemia Covid-19. "Evropa sot shënon Ditën e të Drejtave të Pacientëve. Nga viti 2013 edhe Kosova është bërë pjesë e kësaj kremte. Kjo ditë e gjen pacientin e Kosovës më shumë se asnjëherë tjetër të ekspozuar ndaj një rreziku të madh shëndetësor siç është pandemia Covid-19. Kjo pandemi mori jetën e më shumë se 2 000 qytetarëve tanë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shumë të tjerëve në mënyrë të tërthortë. Menaxhimi i pandemisë që nga fillimi u shoqërua me shumë probleme, gjë që ndikoi në shkelje masive të të drejtave të pacientëve", është thënë në

reagimin e kësaj shoqate. PRAK ka përmendur problemet kryesore: "Ndër problemet kryesore ishin: politizimi i pandemisë që nga fillimi, mungesa e testeve, mungesa e oksigjenit, masat preventive joadekuate, mosrespektimi i masave, fushata e shfrenuar e partive politike, hapja e specializimeve që e la kujdesin parësor me mungesë të madhe të mjekëve, ulja e buxhetit për barna e, krejt në fund, edhe mungesa e vaksinave për qytetarët tanë. Të gjitha këto dhe shumë probleme të tjera shkelën në mënyrë flagrante të drejtën për masa preventive të qytetarëve, të drejtën e informimit të drejtë dhe në kohë reale, të drejtën e qasjes në shërbime shëndetësore, të drejtën e sigurisë së shërbimeve, të drejtën për t'u trajtuar në kohë, të drejtën për të mos duruar vuajtje dhe dhimbje të panevojshme etj", është theksuar në reagimin e PRAK-ut. Në këtë reagim thuhet se në



kohën kur të gjitha vendet evropiane dhe të rajonit kanë vaksinuar një numër të madh të qytetarëve të tyre, Kosova ende nuk ka siguruar asnjë dozë të vetme, të blerë nga buxheti vetjak. "24 000 vaksinat të cilat erdhën si

donacion ende nuk janë administruar pasi që procesi po ecën me hapa të ngadaltë. Në këtë ditë të shënuar, PRAK u bënë thirrje institucioneve që në afat sa më të shkurtër kohor të sigurojnë qasje të qytetarëve për vaksinim, skena

politike të jetë e bashkuar rreth mbrojtjes së shëndetit publik të qytetarëve (përkatësisht votuesve të tyre), qytetarëve t'i respektojnë masat, në mënyrë që të kemi sa më pak persona të vdekur", është thënë në këtë reagim.

A KA KOSOVA NJË STRATEGJI EFIKASE SHTETËRORE?

Efikasiteti i strategjisë shtetërore të Kosovës varet nga disa faktorë, por dy janë më të rëndësishmit: domosdoshmëria e arritjes së një konsensusi nacional, me bazë të gjerë politike dhe shoqërore, që objektiv madhor do ta kishte demonstrimin e një qëndrimi unik kundrejt sfidave që sjell koha dhe bashkërendimi i qëndrimeve dhe veprimeve politike në koordinim të plotë me aleatët tanë strategjikë, sidomos me ShBA-në, sa iu përket hapave që duhen ndërmarrë në raport me çështjet e pambyllura me Serbinë dhe me temat me interes nacional gjithëshqiptar



**Nga Mehmet
PRISHTINA**

A ka Kosova strategji shtetërore për menaxhimin e situatave që sfidojnë integritetin dhe sovranitetin e saj? Kjo pyetje bëhet edhe më aktuale pas publikimit të të ashtuquajturit "Planisloven" për ripërkufizimin etnik të Ballkanit. Zyrtarisht ky plan është hedhur poshtë si i dëmshëm nga ana e qarqeve politike e institucionale të Prishtinës, përfshi edhe presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani. Kjo e fundit ka qenë shumë e qartë kur ka konstatuar se Kosova nuk do të ulet në asnjë tavolinë negociimi ku bisedohet për kufijtë e saj. Por, a mjaftojnë vetëm deklaratat e zyrtarëve, sado të arsyeshme të jenë ato, për të krijuar një frymë gjithëpërfshirëse, jo vetëm mbi temën në fjalë, por edhe për shumë çështje të tjera, që kanë të bëjnë me interesat nacionale të Kosovës dhe popullit të saj. Nëse ndjekim debatet që po zhvillohen ditëve të fundit nëpër studio dhe media të ndryshme, fitohet përshtypja sikur Kosova i ka punët shumë në terezi dhe tani i ka mbetur të merret me tema terciare. Dëmi do të ishte dukshëm më i vogël sikur këto debate të mos prodhonin shikueshmëri të madhe dhe për pasojë Kosova në vend që të merret me rrënjët e problemeve, ajo po harxhon energji të kotë në tema periferike dhe aspak produktive për të sotmen dhe të nesërmen. Qeveria e Kosovës, e cila ende nuk është kompletuar me të gjitha kapacitetet institucionale e

ligjzbatuese duhet patjetër ta hartojë një plan aksionar nacional, në të cilin do të gjenin vend edhe opozita, edhe shoqëria civile, edhe bota akademike e shkencore edhe mediat. Ky plan duhet të përfshijë ato problematika që kapërcejnë interesat e ngushta politike të një qeverie, duke e bërë frontin më të gjerë në një "fushëbetejë" ku ka vend për të gjithë. Ku ka vend, para së gjithash, për ekspertë dhe njerëz të përvojave akademike e shkencore, për diplomatë të karrierës, për autorë që kanë hartuar ligje dhe amendamente kushtetuese si dhe për shumë njohës të funksionimit të shtetit dhe administratës.

Mandati i një qeverie buron në vullnetin politik të atyre që kanë votuar për ndryshime, por strategjia shtetërore është më e gjerë se pushteti i një koniunkturë politike. Efikasiteti i kësaj strategjie varet nga disa faktorë, por dy janë më të rëndësishmit: domosdoshmëria e arritjes së një konsensusi nacional, me bazë të gjerë politike e shoqërore, që objektiv madhor do të kishte demonstrimin e një qëndrimi unik kundrejt sfidave që sjell koha dhe bashkërendimi i qëndrimeve e veprimeve politike në koordinim të plotë me aleatët tanë strategjik, sidomos me SHBA, sa i përket hapave që duhet ndërmarrë në raport me çështjet pambyllura me Serbinë dhe me temat me interes nacional gjithëshqiptar. Deri më tani Kosova ka shkuar në bisedime me Serbinë pa një strategji të qartë shtetërore. Ose, edhe nëse ka pasur njëfarë strategjie, ajo ka qenë e përkohshme dhe ka ndryshuar varësisht nga drejtuesit e shtetit. Pra, nuk ka pasur një strategji konstante, konsistente në parime e qëndrime, e cila do të vlente për një kohë të gjatë, që do të përdorej nga të gjitha qeveritë.

Tani rrethanat kanë ndryshuar dhe binomi Kurti-Osmani,

ashtu edhe siç janë zotuar para votuesve, duhet të praktikojnë një stil krejt tjetër në ngritjen e kësaj strategjie shtetërore të munguar. Por, gjithmonë duke bashkëpunuar me opozitën, dhe duke hapur një debat të gjerë shoqëror.

Kosova ka një mori problemesh të grumbulluara, të cilat nuk mund të tejkalohen për një kohë të shkurtër, prandaj është më se e domosdoshme që t'i lihet kohë qeverisë aktuale që të tregoj në praktikë se çka di dhe çka mundet. Kjo vlen sidomos për mediat, të cilat kanë rol primar të jenë korrektor të qeverisë dhe institucioneve të ndryshme shtetërore, por vetëm duke qenë konstruktiv në kritika. Mediat e Kosovës kanë luajtur një rol të jashtëzakonshëm në demokratizimin e proceseve shoqërore, por jo pak prej tyre kanë qenë zëdhënës të oligarkive të caktuara, të cilat në vend se të merren me probleme madhore, iu kanë dhënë

hapësirë zënkave e konflikteve verbale të brendshme që nuk kanë pasur kurrfarë impakti në interesin publik.

Kosova ka edhe Akademi të Shkencave dhe ka disa universitete. Roli i akademisë dhe i universiteteve është ngushtësisht i lidhur me orientimin e mendimit kritik e shkencor që do të ishte në funksion të strategjisë shtetërore. Një shtet është i gatshëm të hyjë në beteja të vështira politike e diplomatike, vetëm atëherë kur e ka të rrumbullakuar procesin e konsolidimit të brendshëm institucional, akademik, shkencor, intelektual e mediatik.

A mund të themi se shteti ynë e ka këtë konsolidim? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, të shohim se si e kemi gjendjen e botimeve shkencore në gjuhë të huaja, që prekin interesin nacional të Kosovës. Përveç ndonjë paraqitjeje individuale e sporadike, bota shkencore e akademike e Kosovës ende nuk ka prodhuar një opus të kënaqshëm botues që do të ishte referenca kryesore për shumë studiues e diplomatë të huaj që merren me shtetin tonë.

Mediat tona nuk kanë gati kurrfarë hapësire në gjuhë të huaj ku do të plasoheshin pikëpamjet e idetë tona mbi të sotmen dhe të ardhmen. Të gjitha perceptimet e të huajve për Kosovën krijohen tërthorazi, madje jo rrallë edhe

përmes propagandës së Beogradit, e cila është mjaft aktive dhe mjaft sfiduese sa i përket plasimit të të vërtetës së njëanshme serbe në botë. Këtë kohë më parë ma ka konfirmuar edhe një gazetarë i huaj që e pat vizituar Kosovën, i cili kishte shumë nevojë për një rrëfim që do të përmbante dy anën e medaljes. Vetëm pas një bisede me të dhe sidomos pas mënyrës se si i parashtronte pyetjet, erdha në përfundim se ai paraprakisht kishte lexuar materiale të autorëve serbë mbi Kosovën, ku shqiptarët paraqiteshin si njerëz që iu kishin bërë shumë dëme serbëve të përveuajtur. Vetëm kur ia numërova masakrat e kryere mbi shqiptarët nga ana e falangave serbe, kur ia numërova faktet rrëqethëse mbi dhunimet dhe zhdukjen e gjurmëve të të pagjeturve, vetëm atëherë pashë në fytyrën e gazetarit të huaj një drithërimë shqetësimi e keqardhjeje për atë që kishte ndodhur, e për të cilat ai nuk ishte gjithaq i njoftuar.

Nëse këtë qasje tonën e përmbylim me pyetjen e fillimit: A ka Kosova strategji shtetërore për menaxhimin e situatave që sfidojnë integritetin dhe sovranitetin e saj, atëherë na nevojitet që urgjentisht t'i konsolidojmë ata parametra të zhvillimit tonë shoqëror, politik e intelektual të cilat do të mund të shndërroheshin në një platformë të gjerë veprimi.



Drejt një ligji që mban nën llupë pasurinë e pajustificueshme



PRISHTINË, 18 PRILL - Pas miratimit nga Qeveria e Kosovës të konceptdokumentit për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, shumë shpejt pritet të formohet grupi punues brenda Ministrisë së Drejtësisë, i cili do të punojë për hartimin e projektligjit për këtë çështje, konfirmon Genc Nimoni, këshilltar i lartë politik i ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu.

Zyrtarë të Agjencisë Kundër Korrupsionit vlerësojnë se Projektligji për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, në rast se shndërrohet në ligj, pas miratimit eventual në Kuvendin e Kosovës, do t'i ndihmonte shumë luftës kundër korrupsionit, sidomos të atij të nivelit të lartë.

Nismën për këtë projektligj e ka mbështetur edhe Instituti Demokratik i Kosovës.

Genc Nimoni, këshilltar i lartë i ministres së Drejtësisë të Qeverisë së Kosovës, Albulena Haxhiu, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se në grupin punues për hartimin e Projektligjit për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, i cili, sipas tij, do të formohet brenda një kohe të shkurtër, do të ketë edhe aktorë relevantë, përfaqësues nga bota akademike dhe ekspertë të fushës. "Pasi që ligji, do të thotë projekti për të, do të jetë i gatshëm, e që ne po mendojmë ta procedojmë me afate të shpejta, natyrisht, në vazhdimësi duke u konsultuar me aktorë të tjerë nga bota akademike, ekspertë të fushës dhe aktorë të shoqërisë civile, atë ne do ta procedojmë,

përmes ministrisë në Kuvend, për miratim. Ajo që duhet të punojmë më tutje, është konsensusi edhe me subjektet e tjera (politike opozitare), nëse arrihet kjo. Natyrisht ne do t'i ftojme që të kontribuojnë edhe ata", ka theksuar Nimoni.

Ai ka shtuar se pritet që në kuadër të projektligjit të shqyrtohet opsioni i themelimit të një agjencie të pavarur e cila do t'i iniciojë procedurat civile dhe jopenale ndaj personave që dyshohet se kanë përfituar pasuri të pajustificuar apo të paligjshme. Të njëjtin proces, sipas tij, agjencia do ta bartte në gjykatë civile dhe pastaj gjykatës do t'i mbetej të vendoste në bazë të kërkesës së agjencisë. Gjithashtu, siç thotë Nimoni, është diskutuar që ky opsion t'i mbetet prokurorisë, por që barra e provës t'i kalojë palës që i kontestohet mënyra e fitimit të pasurisë.

Agjencia Kundër Korrupsionit dhe IKD-ja mbështesin nismën për ligjin

Nisma e Qeverisë së Kosovës për nxjerrjen e një ligji për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme mbështetet edhe nga Agjencia Kundër Korrupsionit. Drejtori i kësaj agjencie, Shaip Havolli, ka thënë për "Rel" se një ligj i tillë do të ndihmonte shumë në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në aspektin e përfitimeve të kundërligjshme të zyrtarëve të lartë publikë.

Ai ka theksuar se agjencia që ai drejton ka trajtuar disa raste të

niveleve të ndryshme për sa iu përket deklarimeve të prejardhjes së pasurisë dhe tashmë kanë dërguar në prokuroritë përkatëse disa informata për hetime të mëtejme.

Havolli ka theksuar se përderisa ekziston faza e ndryshimit të Ligjit për deklarim dhe prejardhje të pasurisë, fokusi i këtij ndryshimi do të jetë pikërisht prejardhja e pasurisë. "Agjencia nuk ka mekanizma të mjaftueshëm të gjurmimit të pasurisë sepse gjurmimi i pasurisë ose barra e provës është tek agjencia. Për këtë ne kemi dhënë disa vërejtje që t'i jepen kapacitetet ligjore agjencisë, me qëllim që të ketë mjaftueshëm gjurmim të pasurisë dhe për pasurimin e zyrtarëve të lartë", theksoi Havolli.

Mbështetje nismës së Qeverisë së Kosovës për një ligj për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme i jep edhe Instituti Demokratik i Kosovës (IKD).

Florent Spahija, ekspert për çështje ligjore në këtë institut, ka pohuar për "Rel" se një propozim që përfaqësuesit politikë institucionalë të bëjnë një projektligj të tillë, e kishte dhënë qysh para dhjetë vjetësh edhe Instituti Demokratik i Kosovës. Sipas tij, bazuar në konceptdokumentin e miratuar nga qeveria, aspekti civil do ta bënte më të lehtë procedurën për zbatim të ligjit, në rast se ai eventualisht miratohet dhe hyn në fuqi "për shkak se një gjykatë civile do të vendosë për atë nëse duhet të konfiskohet ose jo pasuria. Pra, e tëra çfarë mbetet

është që pala ta dëshmojë para gjykatës që pasuria që pala e ka është e ligjshme. Sipas konceptdokumentit që ne e kemi parë, kjo ka të bëjë më së shumti me zyrtarët shtetërorë, me personat që kanë qenë ndonjëherë zyrtarë shtetërorë apo me personat që kanë marrë para prej buxhetit të shtetit, në çfarëdo forme, pra përfshirë edhe ata që kanë realizuar tenderë të ndryshëm publikë. Kjo është e rëndësishme për shkak se nuk i prek të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës", ka theksuar Spahija, duke shtuar se edhe në qoftë se ligji do t'i përfshinte të gjithë qytetarët e Kosovës, ai nuk beson që kjo do të paraqiste një shkelje të të drejtave të tyre.

Cak i ligjit, zyrtarët, ish-zyrtarët, jo qytetarët

Ditët e fundit në opinionin vendor janë ngritur debate nëse një ligj për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, të cilin e synon ekzekutivi, mund t'i cenojë të drejtat e qytetarëve në përgjithësi. Genc Nimoni, këshilltar i lartë i ministres së Drejtësisë, thotë se dilemat e ngritura lidhur me këtë çështje, me të drejtë ose jo, kanë mjegulluar para opinionit qëllimin e këtij ligji. Ai ka theksuar se për gjithçka rreth këtij projektligji do të ketë transparencë dhe nuk do të ketë paqartësi. Sipas tij, objekt i gjithë kësaj nisme për ligjin është pasuria e pajustificueshme ndaj gjithë zyrtarëve, ish-zyrtarëve që pasurinë nuk arrijnë ta justifikojnë. "Nuk do të jetë cak

qytetari, siç e kanë potencuar disa media dhe përgjithësisht në opinionin publik. Gjithashtu, nuk do të ketë hakmarrje, nuk do të jenë cak subjektet politike apo aktorë politikë. Kjo nuk ka lidhje me këtë dhe është shumë e paqëndrueshme. Ajo që qëndron është se kemi pasur korrupsion të nivelit të lartë në këtë komponentë dhe për ne është shumë e rëndësishme që kjo formë e korrupsionit të eliminohet, së pari dhe, gjithashtu, pasuria që është marrë në mënyrë të kundërligjshme dhe që nuk arrihet të justifikohet, t'i kthehet publikes", ka theksuar Nimoni.

Florent Spahija nga IKD-ja vlerëson që në rast se projektligji për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme do të përmbante edhe krijimin eventual të agjencisë që do t'i niste procedurat civile, kjo agjenci nuk do të ketë kompetenca ekzekutive. Rrjedhimisht, sipas tij, kjo agjenci nuk do të mund të bëjë veprime arbitrare, por vetëm mund ta dërgojë lëndën në gjykatë.

"Nuk po shoh ndonjë mundësi që mund ta ketë kjo agjenci dhe që mund të ketë pasojë për palën që mund të jetë subjekt i saj. Vetë fakti që listohet dhe shkon një listë e pasurisë së dikujt në gjykatë, nuk do të thotë që me patjetër ajo pasuri është e kundërligjshme. Fakti që ekziston e drejta që të argumentohet para një gjykate civile se pasuria e caktuar është e ligjshme dhe është bërë sipas transaksioneve të ligjshme, nënkupton që pala nuk do të ballafaqohet me procedurë penale", ka theksuar Spahija.

Konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme konsiderohet si një ndër shtyllat në luftimin e korrupsionit në Kosovë. Sipas ligjeve aktuale, konfiskimi i pasurisë nënkupton marrjen e përhershme të pasurisë që është fituar në mënyrë të kundërligjshme, sipas urdhrat të formës së prerë nga gjykata kompetente apo organi tjetër kompetent, kurse sekuestrimi nënkupton marrjen e pasurisë nga organi kompetent deri në vendimin e prerë të gjykatës.

Rreth 1.6 milion euro është vlera e asetëve të sekuestruara dhe të konfiskuara në vitin 2020 dhe të cilat janë në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar. Vlera totale e pasurisë së administruar nga kjo agjenci, që nga themelimi i saj një dekadë më parë, është afërsisht 40 milionë euro.



Kështu duket “kalaja” e Haklajve të Tropojës

Familja Haklaj, e njohur qëmoti për kontributin dhënë për çështjen kombëtare, veçanërisht pas viteve '90, ka kaluar nëpër sfida të mëdha. Haklajt, pas vrasjes së djalit, vëllait të tyre të vogël Shkëlqim Haklaj, më 5 janar 1998 në Qafën e Luzhës, në një atentat me armë zjarri automatike, nisnin betejën e hakmarrjeve,

duke vrarë njerëz të dyshuar për vrasjen e vëllait të tyre. Haklajt gjatë luftës së Kosovës kishin krijuar raporte të mira me ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilëve u kanë dhënë ndihmë të vazhdueshme, sidomos vëllai i tyre, Fatmir Haklaj, i cili kishte qenë shef i Komisarariatit të qytetit të Bajram Currit të Tropojës dhe fjala e tij

në atë kohë ishte ligj në zonën e Tropojës.

Pas përfundimit të luftës së Kosovës, në Tropojë vazhdon avazi i gjakmarrjeve, ku në njërin krah qëndronin djemtë e Haklajve të Kërrnajës, të shoqëruar nga shokët e tjerë, Feriz Kërrnaja e Jaho Mulosmani, në krahun tjetër familjet e mëdha tropojane që

dëshironin ta nxirrnin hakun e të vrarëve të tyre si dhe forcat speciale “Renea” të shtetit shqiptar.

Gjatë vitit 1998, sipas drejtësisë shqiptare, Fatmir Haklaj e Jaho Mulosmani kanë vrarë në Tiranë bashkëvendësin e tyre, deputetin demokrat Azem Hajdari. Për këtë çështje në vitin 2001 është arrestuar Jaho

Mulosmani dhe nga drejtësia shqiptare është dënuar me burgim të përjetshëm.

Gjatë viteve 1999 dhe 2000, pas vrasjes së Fatmir Haklajt dhe dy vëllezërve të tjerë të tij, Yll e Halil Haklaj, pothuajse shuhet familja e Haklajve. Shtëpia e tyre rrëzë malit në Kërrnajë, e cila është në të djathtë të rrugës Tropojë - Bajram Curr, ka një gjatësi rreth



15 kilometra, por tashmë është e boshatisur dhe e rrëzuar përtokë.

Ekipi i gazetës "Epoka e re" ka vizituar Kërnajën dhe aty shihen vetëm gjurmët e shtëpisë e cila ka një formë të kalasë, e rrethuar me një mur të lartë, kurse mbi mur janë të vendosura telat me gjemba, për të mos pasur mundësi të kalohet. Në hyrje të dverve kryesore të oborrit është e ndërtuar një "kullë" vrojtuese me "frëngji" që, sipas dëshmitarëve, ajo "kullë" ka shërbyer për t'u mbrojtur nga vrasësit e mundshëm. Në kodrën sipër tyre gjenden varrezat e katër vëllezërve të vranë, të renditur sipas moshës: Shkëlqimi, Fatmiri, Ylli dhe Halili.

Por pas varrosjes së tyre, pra pas vrasjes, ata janë vranë për së dyti! Pothuajse të gjithëve ua



familjen Haklaj

Familja e Haklajve njihet jo vetëm në Tropojë, por në të gjithë veriun e Shqipërisë. Është një nga familjet më të mëdha në këtë rrethinë. Trazirat e vitit

Haklaj, ndihmësgjyqtar në rrethin e Skraparit. Pas kësaj vrasjeje nisën vrasjet e tjera të shumta serike, që kanë lidhje me fisin Haklaj të Tropojës. Ndërkohë, vrasja më e bujshme e kryer prej tyre është ajo e



të fshatit Cërnicë, me mina të telekomanduara, Halil Haklaj e Feriz Kërnaja dhe plagoset rëndë Fatmir Haklaj. Vetëm tre muaj më pas vritet edhe Fatmir Haklaj. Ai është vranë më 4 nëntor të vitit 1999, në një pritë në fshatin Bujan, vetëm 50 metra larg shtëpisë së mikut të tij Jaho Salih. Hakmarrja ndaj fisit Haklaj nuk është ndalur me kaq. Më 3 dhjetor 2000 është kryer ekzekutimi me snajper i djalit tjetër, Ylli Haklaj. Vrasja e

fundit e djemve të familjes Haklaj është kryer më 8 maj të vitit 2002, pranë spitalit të Bajram Currit, ku mbetën të vranë Elez Haklaj dhe i djali i tij, Çelë Haklaj. Të vetmit djem që kanë mbetur gjallë nga "kulla" e Haklajve janë plaku Muharrem Haklaj dhe djali i madh, Hamdi Haklaj, të cilët, pasi u arratisën jashtë Shqipërisë, lanë pas "kullën" dhe varret e shkatërruara të djemve në Kërnajë të Tropojës.




kanë dëmtuar varrezat dhe tanimë janë të vranë edhe në varre! Për të ditur më shumë rreth të 'fortëve' të Tropojës, në krye me protagonistë Fatmir Haklaj e Jaho Mulsomani, mund ta shikoni "Dosjen Tropoja" në "Youtube", në të cilën janë publikuar disa dokumentarë për jetën dhe veprimtarinë e tyre.

Historia e vrasjeve në

1997 bënë që djemtë e kësaj familjeje të bëheshin "bajraktarët" e gjithë Tropojës. Një nga djemtë e Haklajve, Fatmir Haklaj, në atë vit drejtonte policinë e Tropojës. Numri i djemve tropojanë, të vranë vetëm në 16 vjetët e fundit, pas vitit 1997, është rreth 200 persona. Vrasja e parë është bërë në dalje të urës së Milotit, ku viktimë është një nga djemtë e fisit Haklaj, konkretisht Sokol

deputetit të Partisë Demokratike, Azem Hajdari, më 12 shtator të vitit 1998. Më datën 5 janar 1998 vritet në Qafën e Luzhës, në një atentat me armë zjarri automatike, Shkëlqim Haklaj, një tjetër djalë i familjes Haklaj. Pas kësaj vrasjeje nis vrasja e djemve të tjerë të kësaj familjeje të madhe e të njohur, të kryefamiljarit Muharrem Haklaj. Ndërkohë, më 4 gusht 1999, vriten në atentat, në afërsi



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

S'gabojnë favoritët

Fundjava në elitën e futbollit të Kosovës nuk ka sjellë befasi, pasi treshja që po lufton për titull, Drita, Ballkani dhe Prishtina, kanë regjistruar fitore. Duhet cekur se fitore ka realizuar edhe Llapi kundër Gjilanit ashtu si Drenica ndaj Besës



SHKURT

Rashica shënon, por Bremeni mposhtet nga Dortmundi

Reprezentuesi i Kosovës, Milot Rashica, gradualisht po i rikthehet formës më të mirë. Sulmuesi "dardan" zhbllkoi, pas një çerek ore lojë, sfidën me Borussia Dortmundit. Lojtari nga Vushtrria iu shkëput bukur mbrojtjes vendëse, marshoi drejt portës dhe gjeti golin falë një diagonale të saktë. Pavarësisht prej këtij goli, Werderi pësoi humbje me rezultat 3-1.

Manaj shënon golin e 12 në Turqi

Sulmuesi nga Kosova, Arb Manaj, ka vazhduar me gola në Turqi. Manaj realizoi një gol në fitoren 3:0 që e shënoi Balikesirspor në udhëtim ndaj Eskisehirsporit në xhiron e 31-të të Kategorisë së Dytë të Turqisë. Manaj realizoi nga penalltia në minutën e 39. Ish-sulmuesi i Trepçës '89 ka realizuar këtë edicion 12 gola e ka asistuar në tre të tjerë.

Ismajli shënon golin e parë në Serinë A

Çaste feste për Ardian Ismajlin. Mbrojtësi shqiptar e ka gjetur golin e parë në Serinë A. Mbrojtësi kuqezi, i cili u transferua te Spezia në fillim të sezonit, ia ka dalë t'i shënojë Bolognas. Në minutën e 34-t vendasi e Bolognas po kryesonin 2-0, por 24-vjeçari përfitoi nga një goditje këndi dhe gjeti golin e parë në elitën e futbollit italian. Ndeshja përfundoi me rezultat 4-1.

Berisha ia siguron fitoren Salzburgut

Sulmuesi Mërgim Berisha po vazhdon formën e lartë te Red Bull Salzburgut. Ai të dielën shënoi gol për të hapur rrugën drejt fitores të Salzburgut ndaj Laskut. Reprerentuesi i U21 të Gjermanisë, Berisha, shënoi në minutën e 87 për 1-0. Salzburgu golin e dytë e shënoi në minutën e 93-të. Ndeshja i takoi xhiros së 25-të të Bundesligës së Austrisë. Salzburgu udhëheq në tabelë me 35 pikë. Berisha ka arritur në shifrën e dhjetë golave e gjashtë asistimeve në 21 paraqitje. Gjithsej i ka 17 gola.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 PRILL - Java e 29 në Superligën e Kosovës në futboll ishte mjaft interesante, kurse tri skuadrat që po luftojnë për titull ishin të pagabueshme duke marrë tri pikët e radhës. Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Drita, ka shënuar fitore ndaj Trepçës '89 (0-1). Në pjesën e parë nuk u shënuan shumë raste shënimi, kurse në minutën e 52-të Ilir Blakçori ndalet në mënyrë të palejuar në zonën e rreptësisë nga Albion Pllana, e gjyqtari kryesor akordoi penallti. Festim Alidema ishte i saktë nga pika e bardhë dhe shënoi për rezultatin 0-1. Vendësit u përpoqën ta barazojnë rezultatin por, pa sukses. Pas tri pikëve të reja, Drita e ruan pozitën e parë në tabelë me 64 pikë. Trepça '89 renditet në vendin e gjashtë me 35 pikë, ndërsa skuadra e Ballkanit nuk ka gabuar në derbin ndaj Feronikelit, pasi ka shënuar fitore me rezultat 0-2. Në këtë mënyrë skuadra nga Suhareka është rikthyer në vendin e dytë dhe e vazhdon garën për titull me Dritën dhe Prishtinën. Në tridhjetë minutat e parë mysafirët

rezikuan më shumë, por vendasit patën një rast të mirë shënimi kur Përparim Islami gjuan nga distanca dhe Ljuljanoviq me ndihmën e traversës e dërgon topin në këndore. Tre minuta më vonë realizon Ballkani nëpërmjet Ermal Krasniqit për 0-1. Në minutën e 51-të, Yll Hoxha qëllon traversën pas një goditje të fuqishme nga afërsia. Në minutën e 76 Ballkani realizon edhe golin e dytë me anë të Mirind Dakut, i cili ishte i saktë nga penalltia. Ballkani rikthehet në vendin e dytë me 61 pikë, kurse është në vendin e shtatë me 34 pikë. Të shtunën Prishtina ka realizuar fitore në duel me skuadrën e parafundit në renditje, Arbërinë, në stadiumin "Fadil Vokrri", me rezultat 2-0. Me këtë fitore prishtinasit ruajnë hapin me dy konkurrentët e tjerë në garën për titull, Dritën dhe Ballkanin, derisa Arbërinë e pret punë e vështirë për ta siguruar mbijetesën. Golat për Prishtinën i shënuan Gauthier Mankenda (5') dhe Besnik Krasniqi (11' nga penalltia). Fitore tejet të rëndësishme si mysafir ka realizuar Llapi në përballje me Gjilanin me rezultat 2:0. Të dy golat për llapjanët i ka shënuar Edon Sadriu. Ky i fundit i

realizoi ish-skuadrës në minutën 20 dhe 53-të. Me këtë fitore Llapi ngjitet në kuotën e 36 pikëve, kurse Gjilani mbetet në kuotën e 43 pikëve.

SUPERLIGA - Java 29

Feronikeli - Ballkani	0-2
Trepça '89 - Drita	0-1
Gjilani - Llapi	0-2
Prishtina - Arbëria	2-0
Besa - Drenica	1-2

Tabela

1. Drita	29	64 pikë
2. Ballkani	29	61
3. Prishtina	29	60
4. Gjilani	29	43
5. Llapi	29	36
6. Trepça '89	29	35
7. Feronikeli	29	34
8. Drenica	29	33
9. Arbëria	29	27
10. Besa	29	10

Në xhiron e radhës takohen: Arbëria - Besa, Drenica - Feronikeli, Drita - Prishtina, Ballkani - Gjilani, Llapi - Trepça '89.

Bayerni refuzon kërkesën e trajnerit Flick që të largohet në fund të sezonit

MUNCHEN, 18 PRILL - Hansi Flick informoi të shtunën se do të largohet nga Bayern Munchen në fund të sezonit. Megjithatë, kjo kërkesë është refuzuar të dielën nga Bayerni. Nëpërmjet një komunikate, bordi dhe trajneri ishin marrë vesh që të zhvillohen tri ndeshjet e

ardhshme e më pas të bisedohet për këtë çështje. Kjo është edhe arsyeja pse nuk i është miratuar kërkesa Flickut. "Hansi Flick, trajner kryesor i FC Bayernit, informoi publikun në lidhje me dëshirën e tij për ta ndërprerë kontratën e tij, e cila zgjat deri në qershor

2023. Hansi Flick e kishte këtë dëshirë javën e kaluar. Hansi Flick dhe FC Bayern u pajtuan të përqendrohen në ndeshjet kundër VfL Wolfsburg, Bayer 04 Leverkusen (20 Prill) dhe 1. FSV Mainz 05 (24 prill) në mënyrë që të mos shqetësohet përqendrimi i

plotë i të gjithë klubit në këto tri lojëra të rëndësishme. FC Bayern nuk e miraton komunikimin e njëanshëm nga Hansi Flick dhe do t'i vazhdojë bisedimet siç është rënë dakord pas ndeshjes në Mainz", thuhet në njoftimin e Bayernit.



Besa bën hapin e parë drejt finales, Prishtina fiton bindshëm ndaj Trepçës

PRISHTINË, 18 PRILL - Besa Famgas ka bërë hapin e parë drejt finales së "play off"-it në Superligën e Kosovës në hendboll. Skuadra pejane të shtunën e fitoi ndeshjen e parë gjysmëfinale të "play off"-it. Në palestrën "Karagaçi", Besa Famgas e mposhti Vëllaznimitin e Gjakovës me rezultatin bindës 40:19. Pas pjesës së parë rezultati ishte 18:11. Arnbios Mushkolaj ishte më efikas te pejanët me 10 gola. Yll Muqolli i realizoi 6 gola. Te Vëllaznimiti më efikas ishte Ardi Halili me 6 gola. Ndeshja e dytë luhet në mesjavë në Gjakovë, ndërsa Besa nuk pritët të ketë telashe për të kaluar në finale. Besa Famgas i ka fituar të gjitha ndeshjet në edicionin e rregullt dhe është kampione në fuqi. Me fitore bindëse Prishtina e ka nisur serinë gjysmëfinale të "play off"-it ndaj Trepçës. Ndeshja e luajtur




të shtunën pasdite në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në kryeqytet përfundoi me fitoren 40:26 të Prishtinës. Skuadra prishtinase herët nisi shkëputjen në rezultat dhe pjesa e parë përfundoi 19:9. Tani Prishtinës i duhet edhe një fitore ose një barazim për të

kaluar në finale të "play off"-it. Ndeshja e dytë luhet në Mitrovicë, në mesjavë. Rron Ramadani shënoi 8 gola për Prishtinën, ndërsa Lulzim Shabani i shtoi 7 gola. Amar Mujka ishte më efikas te Trepça me 7 gola.

Golden State ndalet nga Bostoni, Lakersat triumfojnë në shtesë

Los Angeles, 18 prill - Pas katër fitoreve radhazi, Golden State Warriors ndalet në transfertën e vështirë ndaj Boston Celticsit që ofroi edhe një duel brenda sfidës në mes të dy yjeve, Stephen Curry dhe Jayson Tatum, të dy në një formë fantastike. Në "TD Garden" të Bostonit ishin miqtë ata që e nisën mjaft vullshëm ndeshjen, duke fituar fraksionin e parë me shifrat 24-33, falë edhe formës së shkëlqyer të Stephen Curryt, që shënoi 47 pikë, rikuperoi 7 topa dhe dha 3 asistime. Megjithatë, Bostoni reagoi mirë më pas dhe arriti të fitojë në të tri pjesët e tjera, duke triumfuar me rezultatin final 119-114, ndërsa për Celticsin spikati Jayson Tatum me 44 pikë, 10 rikuperime dhe 3 asistime. Kjo ishte fitorja e 6 radhazi për Boston Celticsin, që ka blinduar pozitën në zonën "play-off" të renditjes në Konferencën e Lindjes, ndërsa Warriorsi duhet të djersitet ende shumë për të siguruar një vend në fazën finale. Pas katër fitoresh radhazi, ndalet edhe Phoenix Sunsi, që u mposht në shtëpi nga San Antonio Spursi me rezultatin final 85-111. Spursi e nisi vullshëm ndeshjen dhe fitoi në dy fraksionet e para me



diferencë pikësh, të cilën e ruajti më pas deri në fund të takimit, ndërsa për Phoenixin zhgënjeu basketbollisti nga Bahamasi, Deandre Ayton, i cili shënoi vetëm 8 pikë, ndonëse qëndroi në fushë për më shumë se 26 minuta. Ka marrë një fitore me mjaft vlerë Los Angeles Lakersi, që triumfoi me shifrat 127-115 në "Staples Center" përballë kryesuesve të Konferencës së Perëndimit, Utah Jazz. Pas një nisjeje disi të vakët, kalifornianët reagan në fraksionin e dytë dhe të tretë, duke shkruar në pjesën e fundit me 14 pikë diferencë, por këtu u zgjuan sërish miqtë e Jazzit, të cilët bënë që koha e

rregullt të mbyllej barazim, 110-110. Koha shtesë foli tërësisht për Lakersat që, të udhëhequr nga dyshja Drummond - Schroder, ia dolën të fitojnë me rezultatin 17-5, duke siguruar kështu suksesin edhe në të gjithë takimin me shifrat 127-115. Në sfidat e tjera Chicago Bulls fitoi me rezultatin 106-96 ndaj Cleveland Cavaliersit, Washington Wizardsi mposhti Detroit Pistonsin me rezultatin 121-100 falë një forme mjaft të mirë të Bradley Bealit, ndërsa Memphis Grizzliesi regjistroi suksesin me shifrat 115-128 në transfertën ndaj Milwaukee Bucksit.

SHKURT

Barcelona fiton Kupën e Mbretit

Barcelona nuk njih rivalë në Kupën e Mbretit. Katalanasit e kanë ngritur për herë të 31-të këtë trofe, pasi mposhtën Athletic Bilbao me rezultatin 4-0. Unai Simon shpëtoi nga shtylla pjesën e parë, pas një goditjeje të De Jong, ndërsa në fillim të fraksionit të dytë të lojës ndali Pedrin dhe Busquetsin. Këmbëngulja e Barcelonës u shpërblye. Griezman zhblloko rezultatin pas një ore lojë, kurse tre minuta më pas De Jong me kokë dyfishoi shifrat dhe praktikisht Bilbao u dorëzua ndaj supermacisë së skuadrës së Koemanit. Skenën më pas e mori Leo Messi, i cili për pak minuta ndëshkoi edhe dy herë skuadrën baske, kurse VAR i shpëtoi nga goli i pestë që u realizua nga Griezmanni. Bilbao doli kokulur dy herë brenda pak kohësh, pasi e kishte mposhtur edhe Sociedadadi në finalen e Kupës të sezonit të shkruar.

Ronaldo refuzon rikthimin tek Unitedi

Cristiano Ronaldo ka kontratë me Juventusin deri në verën e vitit të ardhshëm. Gjatë kësaj kohe nuk kanë munguar zërat e largimit nga Serie A, por 36-vjeçari portugez ka refuzuar një ofertë së fundmi. Një nga ish-klubet e tij, Manchester United, tentoi t'i mbushte mendjen për t'u rikthyer në "Old Trafford", aty ku shkëlqeu gjatë viteve 2003-2009. Problemi i vetëm mbetet rroga sezonale. "Djajtë e Kuq" i kanë ofruar 17 milionë euro në sezon, por ylli i kampionëve të Italisë ka kërkuar të paktën 20 milionë euro. Vetëm tre milionë euro larg, por që kanë mjaftuar që CR7 ta refuzojë kalimin tek ekipi i Ole Gunnar Solskjaer për sezonin e ardhshëm.

Quartararo triumfon në Portugali dhe merr kreun e renditjes

Piloti francez i Yamahas, Fabio Quartararo, fitoi garën e Çmimit të Madh të Portugalisë në MotoGP, garë e zhvilluar në pistën e Portimaos. Suksesi i dytë sezonal për Quartararo, që e nisi garën nga "pole" dhe e mbylli atë në krye, duke treguar superioritet në pistë. Falë këtij suksesi piloti francez merr kreun e renditjes së botës, ndërkohë që të tri garat e zhvilluara deri më tani në MotoGP i kanë fituar pilotët e Yamahas, fakt që tregon se motori japonez është në formë të mirë. Në vendin e dytë u rendit italian Francesco Bagnaia me Ducati, që e nisi garën nga vendi i 11-të, duke bërë një garë të mirë dhe përfituar nga rrëzimet e rivalëve, si Johann Zarco dhe Alex Rins, që e mbyllën garën para kohe. Në podium u ngjit edhe spanjoli Joan Mir me Suzuki, që bëri një garë konstante. Në debutimin e tij sezonal me Honda, spanjoli Marc Marquez u klasifikua në vendin e shtatë. Tjetër garë për t'u harruar ajo e Valentino Rossit me Yamaha Petronas, që u rrëzua në mesin e garës.

Miami GP do të jetë pista më e re në Formula 1

Formula 1 sapo ka dhënë lajmin se ka arritur marrëveshje për një pistë të re. Nga viti 2022 Formula 1 do ta nisë garën e Miami GP, e cila do të mbahet afër "Hard Rock Stadium". Kjo garë e cila do të jetë e para që nga viti 1959 në shtetin amerikan, do të mbahet në një plan urbanistik të ri emocionues në kompleksin "Hard Rock Stadium" në Miami Gardens, shtëpia e klubit të famshëm të NFL Miami Dolphins. Kontrata është firmosur për 10 vjetet e ardhshme dhe gara prestigjioze tani ka vendin edhe në Amerikë. Pista ka 19 kthesa dhe do të jetë e gjatë 5.41 km. Formula 1 ka bërë me dije lajmin në uebfaqen zyrtare dhe përmes llogarisë në "Twitter". Miami do të jetë vendi i 11-të që Formula 1 ka garuar në Shtetet e Bashkuara që nga fillimi i kampionatit më 1950, pas Indianapolis, Sebring, Riverside, Watkins Glen, Long Beach, Las Vegas, Detroit, Dallas, Phoenix dhe Circuit of the Americas në Austin.



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti

Daut Dauti

Daut Dauti NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë



Prallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kiesłowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kiesłowski, i ndërthurur me një egzgjenezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te në nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kiesłowski, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kiesłowski dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kiesłowski

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚŁOWSKI

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftohen të interesuarit se më datë 26.4. 2021 (e hënë), në orën 12:00, në sallën e Dekanatit të Fakultetit të Filologjisë, të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Faton Krasniqi do ta mbrojë temën e doktoratës me titull “Analizë leksikore dhe terminologjike e teksteve shkollore të lëndës gjuhë shqipe dhe letërsi për klasat 6 - 9 në Kosovë”.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ejup Krasniqi shpall të pavlefshme ID-kartelën e Kolegjit AAB, Prishtinë me nr. Re-2274/15
- Ibrahim Shkreta shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Mati Logoreci" Prizren.
- Zymer Fetahi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Bajram Curi" Romajë.
- Suad Gutaj shpall te pavlefshme dëftesat shfmu "Heronjtë e Lumes" Vermicë.
- Zejnulla Gutaj shpall te pavlefshme dëftesat shfmu "Heronjtë e Lumes" Vermicë.
- Elza Mustafi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Ekrem Rexha" Gencare.
- Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

